

NR: 01-581  
Data: 08.11.2018



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 17.10.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic dhe përfaqësuesit e OSBE-es.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendetë të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

**Rend dite**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Njoftim nga menaxheri i Kompanis EccoHigjena rreth aksionit ta pastrojm Kosoven;
3. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbale u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

**Pika e dytë:** Njoftim nga menaxheri i Kompanis EccoHigjena rreth aksionit ta pastrojm Kosoven;

Kryesuesja e komitetit tha: pasi qe prezantuesi i kesaj pike mungon kalojm ne piken te ndryshme nese keni ndonjë diskutim.

**Pika e tretë:** Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi pershendetë të pranishmit: mendoj se në këto mbledhje duhet të jemi më serioz, pasi që tregohmi në nivel të ulët edhe para qytetarëve dhe para përfaqësuesve të cilët na percjellin neve, me pas pikë të rednit të ditës dhe mos me qenë prezent dhe e dim se Komiteti për Komunitete është shumë i rëndësishëm ku i mbron te drejtat e komunitetit qoftë pakic por edhe ati shumicë, ne vim ne mbledhje nënshkruhem i dëshiron se që kemi mbajtur dhe ende nuk kemi mundur të shtym ndonjë pikë për mbledhje të Kuvendit, ne duhet të tregojm që po punojm këtu diçka dhe mos te jemi në ata nivel që po vim vetem për meditje, edhe Kryesuesja nese ka nevoj për me i ndihmu mundemi ti ndihmojm ne përpilimin e rendit të ditës. Ka qenë mirë që është pastruar dhe ka pasur shumë vullnetar ku kanë marrë pjesë edhe shokë të mi dhe njerzë familjar por nuk do të

thot kjo që ka përfunduar me një pastrim 1 herë në vit, por bashkarisht ndoshta do të mund të punojm në ndonjë projekt për deponit, nese ka munges të mjeteve cili është problemi. Vetem kërkoi që këto mbledhje të mirren më seriozisht, e kuqtoj Kryesuesen që është e re në udhëheqje por ndoshta mundet ti ndihmoj dikush edhe prej nivelit këtu në pregaditje.

Jorgovanka Filic pasi përshendetë të pranishmit tha: une e kam udhëhequr komitetin, edhe atëher ka funksionuar kështu, duhet te jen kushtet që të këtë bashkpunim me zyren e Komitetave për Komunitete, në kohen që kam udhëhqur unë kam pasur kërkesa prej qytetarëve dhe ne kemi arritur që të ndertojm në shtëpi për nënrat vetëushqyese përmes zyrës së Komitetave, është me rëndësi që të ketë komunikim me qytetarët të gjithë ne duhet të bisedojm dhe të diskutojm pasi që ky është komitet për komunitete dhe ne kur ti kemi kërkusat e tyre mundëti vendosim priorititet që të shkojnë në Kuvend. Pajtohem që së bashku të punojm për pika të rendit të ditës.

Kryesuesja e Komitetit tha: ju kam treguas se kur keni ndonë pikë për rend dite ju mund të më njoftoni që ti shtoj në rend dite.

Dobrivoje Djordjevic tha: pajtohem me parafolsitë por me heret ka qenë që çdo Drejtori çdo tre muaj te sjell raport apo informat për prezantim dhe kështu duhet të jetë që çdo Drejtori të raportoj në mënyr që në të informohemi për punën e tyre. Sa i përket qytetarëve ata mundet edhe të sjellin kërkesa, por ne duhet të shqyrtojm raportn e Drejtive dhe aj raport kur te prezantohet në Kuvend ne mundë të deklarohemi që spo na pelqen puna e atij Drejtorati. Por në këtë mënyr mendoj se është bojkotuar komiteti, kryesuesja nuk është e njoftuar për këto qështje por ne në një mënyr jemi opozit e qështjeve të Komunës, qështja tjeter është se perveq përkthyesit edhe procesëmbajtjes asnjë zyrtar tjeter nuk është prezent edhe personat te cilet e monitorojn këto mbledhje mundet me cek se këtu nuk ka kurfar bashkpunimi në mes të komitetit dhe egzekutivit, ju faleminderit.

Aleksander Pavic pasi përshendetë të pranishmit tha: nuk e fajtësoj askend, ne si komitet duhet njëher të bisedojm me vjetvetin dhe të shohim se ku është problemi a është te ne. Ne si komitete duhet të pregaditemi, ti dergojm ftesë shefes së kabinetit të zyres Komunale për kthim, Nënkyetarit për Komunitete që të marrin pjesë në Kuvend, ne duhet ti dergojm ftesen së paku edhe një Drejtore që të vij të raportoj, nese janë të gjithë me kohë të njoftuar edhe atëher ata mungesen e tyre duhet ta arsyetojnë, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic tha: është obligim i çdo drejtorie dhe nuk duhet ti dergojm ftesë pasi që është obligim ligjor që të vij të raportoj, shembull kur ka raportuar shefja e zyres se kthimit ka lexuar njoftim 45min as nuk kemi diskutuar as nuk kemi votuar. E gjashta mbledhje e komiteti që është mbajtur dhe asnjë drejtori nuk ka raportuar, unë kam biseduar me antarët të komitetave nga komunitat e tjera dhe kan thënë se me ligj është obligativ që të raportoj çdo tre muaj.

Aleksander Pavic tha: e kam cek edhe me heret që duhet të kemi planin e punës së komitetave që ti dim kompetencat e këtij komiteti dhe sa i përket përgaditjes së ftesave dhe rendit të ditës ne në fundë të kësaj mbledhje mundëtë diskutojm që të formojm pika për mbledhjen e ardhshme. Ne nuk kemi rregullore për punen e komitetit për komunitete, pra nese Komuna janë nuk e ka atëher të shikojm Komunitat e tjera dhe të marrim shembull pasi që në rregullore përfshihen të gjitha punët, detyrat dhe kompetencat e komitetit për komunitete. Unë kpropozoj që nese nuk ak diskutime tjera të ndërprenjm mbledhjen dhe të diskutojm për rend ditë për mbledhje të ardhshme.

Abdyl Gahi tha: nuk kemi nevoj mi shiku Komunitat e tjera pasi që veç kompetencat janë të qarta të komitetit, nuk jemi ne këtu që të bëhem i dëgjuar të mirë dhe krejt çka duhet të bëjmë është të ndëgjojm raport pa inicu asnjë pikë për asamble. Ne në Komunë po shohum se asambleja Komunale po anashkalohet çdo herë e më shumë, propozohet arovimi i buxhetit dhe Kryetari i Komunës nuk merr fare pjesë në seanc dhe buxheti propozohet prej një personit të paautorizuar, formohen komisione brenda seancave, komisoni për emrim të rrugeve që sa muaj është formuar dhe nuk është punuar asgjë, është ndar një shumë në vlerë prej 5,000€ per me ju nda qytetarëve të dëmtuar nga vjedhjet e

kafshëve, është formuar komisioni me antarë të Kuvendit dhe asnjë herë nuk jam ftuar dhe nuk e di se ku kan shkuar ato mjete, njejt ndodhë edhe me furnizim të druve, përveq kësaj ne e kemi të drejten për me u qas në dokumente zyrtare ku ne si komitet mundemi me bë një kërkesa bashkarisht ose në mënyrë individuale që të kérkojm raport për këtë komision, ose të kérkojm raport prej Kryetarit të komisionit për emrim të rrugëve krejt këto mundemi ti bëjëm bashkarishtë. Me ligj dhe rregullore Komuna është e obliguar që seancat e Kuvendit të transmetohen live në ëeb faqe zyrtare, qytetarët na kanë votuar ne dhe kanë deshirë të shohin punën tonë, nese ka transparenc dhe ka punë të mirë besoj se kanë deshirë ti shpalosin para qytetarëve, ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.  
Mbledhja përfundoi ne ora 10:30

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku

Kryesuese i Komitetit për Komunitete

